



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
REKTORATI

Nr. 100/L Prot.

Vlorë, më. 05.11.2021

VENDIM

NR. 24, datë 05.10.2021

PËR

**FILLIMIN E PROCESIT TË AKREDITIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT
MASTER PROFESIONAL DHE SHKENCOR.**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 15.02.2017, Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe në Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.10.2021, Rektorati

VENDOSI

1. Fillimin e procedurave të akreditimit për programet e ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional dhe Shkencor.
2. Njësitë bazë të paraqesin pranë Zyrës së Rektorit, brenda datës 10 nëntor 2021 kërkesën për akreditimin e programeve të studimit që zhvillojnë.
3. Kërkesat e Njësive bazë të përcillen në ASCAL dhe t'i kërkohen Senatit Akademik dhe Bordit të Akreditimit burimet financiare.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillim Institucional, Zv. Rektori Akademik, drejtuesve të njësive kryesore, drejtuesve të njësive bazë dhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI

